



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 45-të të mbajtur me datë 29.12.2020 morri

VENDIM

Denoncimi për korrupsion me nr. 12-5093/1 me datë 06.11. 2019 e dorëzuar nga parashtrues nga, **REFUZOHET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutejshëm për lëndën 12-5093 nga viti 2019, formuar pas denoncimit nr. 12-5093/1 me datë 06.11.2019, kurse lënda do të dorëzohet në veprim kompetent të Dhomës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lënda me numër 12-5093 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-5093 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit/parashtresës nr. 12-5093/1 me datë 06.11.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga ana e parashtruesit nga

Në denoncimin e dorëzuar janë shprehur akuza për punë joligjore dhe veprim të Shoqatës së Avokatëve nga, në lidhje me kërkesën e lartë si kompenzim për përfaqësim në lëndë për padi të ngritur.

Në denoncim është bashkangjitur dhe kërkesë plotësues me shkrim nga parashtruesi i njëjtë, e cila është e vulosur me numër të arkivës 12-3346/1 me datë 28.09.2020, si dhe Kërkesë, sqarim, informacione dhe dëshmi për akuzat në parashtresë e vulosur me numër të arkivës 12-3346/2 me datë 10.12.2020, dorëzuar deri te Avokati i popullit Këtë kërkesë avokati e dorëzon në lidhje me deri te ai e dorëzuar parashtresa e personit nga....., e cila ka qenë dorëzuar kundër KSHPK me të cilën ai kërkon intervenin nga Avokati i popullit për arsye të shtyrjes së vendimmarrjes për kërkesën e tij parashtruar me datë 25.09.2020 e vulosur me numër 12-5093/1. Me Kërkesë, avokati i popullit kërkon që KSHPK të dorëzon përgjigje me shkrim për masat e ndërmarra dhe kopjet nga akt-vendimer e marra për parashtresën e dorëzuar.

Gjatë rishikimi të denoncimit, KSHPK i merr parasyshë akuzat e parashtruesit me çka konstaton se në lëndën bëhet fjalë për akuza ose informime për veprime joligjore ose të patolerueshme të personave zyrtar gjatë kryerjes së autorizimeve publike dhe detyrës zyrtare në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka kompetenca për veprim

për rastin e lëndës, denoncimi të rrefuzohet dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet, kurse lënda të dorëzohet deri në veprim kompetent në Dhomën e avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Njëherit, KSHPK do të dorëzon informim edhe deri te Avokati i popullit me informime për veprimin e vet kompetent dhe do t'i dorëzon kopje nga akt-vendimet e miratuara për këtë lëndë.

Duke pasë parasyshë të theksuarën më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi si me dispozitat e këtij vendimi.

Është vendosur me datë 29 dhjetor 2020, me numër 12-3346/3

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe parashtruesi

Pas përfundimit të KSHPK;

Punoi: J. C., Këshilltarë

Miratoi: m-r V. G., anëtarë i KSHPK

KOMISIONI SHTETËRORE PËR
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Zëvendës-kryetarë: Sofka Pejovska Dojçinovska

